



Data: 08.08.2017

Ref.: 66117

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

#### V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa nr.561/17, datë 20.07.2017 e Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” për rishqyrtim te vendimit te KSHC-së nr.535/17, datë 06.07.2017 si e pabazuar.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.535/17, datë 06.07.2017.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### Arsyetimi

Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë me 20.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim te vendimit të KSHC-së nr. 535/17, datë 06.07.2017, me te cilin vendim Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë nuk janë riakredituar programet e studimit: Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS, dhe Menaxhment dhe Informatikë, BA, 180 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit te dorëzuar nga Universitetin “Isa Boletini”, KSHC ka konstatuar që institucioni në fjalë nuk ka sjellë asnjë dëshmi mbi bazën e të cilës do të mund të merrej parasysh për të ndryshuar vendimin e KSHC-së. KSHC konsideron se gjendja faktike në kohën e vlerësimit të aplikacionit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” është trajtuar me saktësi maksimale nga AKA.

Vendimi i KSHC për mos riakreditim te programeve të studimit në Universitetin “Isa Boletini”, është në përputhje të plotë me nenin 22, pika 2 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (UA nr.20/2016, datë 20.09.2016) ku thuhet: “Duke u bazuar në rekomandimet nga raporti i ekspertëve, KSHC do të vendos për akreditim ose mosakreditim”. Në Raportin Final të hartuar nga ekspertët për Universitetin “Isa Boletini”, në faqen 45, decidivisht thuhet që “Nuk rekomandohet ri/akreditimi i këtyre dy programeve në formatin ekzistues”.

Andaj, bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetin "Isa Boletini",
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

